

Fjalim i deputetit Isuf Çelaj

13.07.2023

– E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

E ndoqa me vëmendje raportin vjetor të mbajtur nga zonja Sula, drejtuesja e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Po ashtu, jam njohur edhe me projektrezolutën e Kuvendit për këtë institucion dhe në vazhdim po paraqes disa projeksione, të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e punës dhe arritjen e objektivave të këtij institucioni kushtetues.

Duke analizuar pikën 2 të rekomandimit të Kuvendit, mendoj se, duke qenë se Autoriteti është i detyruar me ligj t'u shërbejë dhe të bashkëpunojë me institucionet kushtetuese të shtetit, është detyra jonë si legjislativ t'i detyrojë me ligj institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike, që t'i drejtohen Autoritetit të Dosjeve me kërkesë për riverifikim të figurës së zyrtarëve të pajisur më parë me certifikatë pastërtie, pasi Autoriteti nuk bën verifikime kryesisht dhe, nëse do të lihet evazive në kuadër të bashkëpunimit sipas dëshirës, rrezikon të kemi keqpërdorimin e verifikimeve selektive, me mundësi shmangieje e mosdhënie përgjigjeje për subjekte të ndryshme, duke e kthyer në gjueti shtrigash ndaj personave të ndryshëm dhe sipas porosive politike të shefave. Kështu siç është ndërtuar ky rekomandim, e detyron Autoritetin të veprojë në formë lutjeje për bashkëpunim, ndërsa për palën tjetër, për institucionet, bashkëpunimi mbetet fakultativ, sipas dëshirës.

Po ashtu, edhe në pikën 5 të rekomandimit, përveç se të shkruhet, duhet të shprehet qartë, të parashikohet dhe të merren masa konkrete për vënien para përgjegjësisë të të gjitha institucioneve, të cilat kanë dhe vazhdojnë të mbajnë dokumente që kanë të bëjnë me ish-Sigurimin dhe veprimtarinë e tij. Brenda një afati të arsyeshëm dhe sa më të shkurtër, ky dokumentacion duhet të dorëzohet tek Autoriteti, sipas parashikimeve ligjore në origjinal ose në dublikat, në mënyrë që t'i shërbehet publikut, siç dhe ligji 45/2015 dhe VKM-të përkatëse e parashikojnë.

Më së shumti, kjo kategori dokumentacioni mbahet në arkivin e Ministrisë së Brendshme dhe, nga informacionet që unë kam, padrejtësisht po përgatiten aktet e transferimit në Arkivin Qendror të Shtetit, duke ndjekur fatin e dokumentacionit të ish-Hetuesisë së Përgjithshme, i cili mbahet i vdekur, ndonëse është përgatitur dhe është i lidhur totalisht me veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit, pasi hallka kyçe e veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit ishte hetuesia. Në fakt, aty

montoheshin dhe fabrikoheshin të gjitha akuzat ndaj qytetarëve, duke i torturuar me metodat më makabre dhe shtazarake, duke i detyruar të pranonin fajet dhe veprime që nuk i kishin bërë kurrë.

Ky material i arkivit të Hetuesisë së Përgjithshme, nga koha kur është dërguar në Arkivin Qendror të Shtetit dhe nga fillimi i veprimtarisë së Autoritetit, me kapacitetet që ai ka dhe me ritmet që ka ecur, do të ishte përpunuar e njëherazi do t'u ishte shërbyer subjekteve përkatëse, të cilave u takon të njihen me këto dokumente, duke mos i mbajtur e lënë të vdekura, njëherazi në funksion të publikut dhe për të shmangur çdo dyshim për fshehje të qëllimshme, gjë e cila mund të thuhet me plot gojën për dokumentet e arkivit të ish-Partisë së Punës së Shqipërisë, e cila ishte ideatorja, krijuesja, organizatorja dhe drejtuesja e armës famëkeqe të ish-Sigurimit të Shtetit, ku raportohej për gjithçka dhe nga ku merreshin direktivat dhe urdhrat. Mbajtja më tej dhe mosshërbimi i këtij dokumentacioni e bën procesin të mangët, njohjen e kujtesën të zbehtë dhe komprometimin e të gjithë aktorëve e faktorëve në këtë proces të hapjes së dosjeve dhe të njohjes së të kaluarës dhe të krimeve të komunizmit. Po kështu, dokumentet që duhet të jenë në Autoritet, të cilat e kanë mbaruar funksionin për të cilin janë krijuar, tashmë janë vetëm me vlerë historike dhe studimore, dhe, fatmirësisht, jo vetëm kemi miratuar ligjin për deklasifikimin e tyre total, por edhe afatet kohore, pa ndryshimet tona, e kanë bërë të tyren.

Nuk mund të vazhdohet vetëm me dosjet e përndjekjes së viktimave, por të zgjerohet diapazoni me ato të strukturuesve e superstrukturës, që mbahen akoma të fshehura pas krijimit të Autoritetit, gjë të cilën mund ta them me plot gojën. Ata oficerë sigurimi e hetues nuk paskan faj e përgjegjësi që i kanë detyruar forcërisht me dhunë e terror këta qytetarë, për të nënshkruar si bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit të Shtetit! Kjo është e paligjshme dhe e pamoralshme, e komprometon këtë proces dhe faktohet politikisht hapja e pjesshme, jo e plotë, dhe vetëm e dokumentacionit të viktimave, duke i viktimizuar për së dyti, duke u hapur plagë të reja. Por ne duhet të kthehemi në kohë e të gjykojmë rrethanat në të cilat ata janë detyruar ta pranojnë bashkëpunimin, me dhunë dhe me të gjitha format e presionit. Kështu që, ky do të mbetet vetëm një veprim për të hedhur hi syve, sa për të krijuar mjegullnajë.

Po kështu, dokumentacion që lidhet me ish-Sigurimin ka edhe në Ministrinë e Jashtme, ka edhe në Ministrinë e Mbrojtjes, si dhe në arkivat personale të ish-oficereve dhe të hetuesve të kohës së ish-diktaturës komuniste. Kjo kategori e përdor këtë dokumentacion për presion, si dhe i shet nëpër medie, në disa raste edhe të deformatuara apo dhe sipas interesave të tyre okulte. Prandaj, të gjitha këto materiale, të këtyre arkivave, duhet të dorëzohen tek Autoriteti, që të përpunohen sipas ligjit që normon punën e tij.

Me shumë rëndësi mbetet zgjidhja e situatës së procesit të gjetjes së të zhdukurve dhe e rikuperimit të pasojave, barrë të cilën ia kemi ngarkuar Autoritetit, duke e "dërguar në pyll pa sëpatë". E them kështu, pasi as nuk i janë parashikuar fonde dhe për këtë është bërë pengesë nxjerrja e një VKM-je që i hap rrugën veprimit, pasi pa këtë VKM, Autoriteti dhe institucionet e tjera të përfshira në këtë ligj nuk mund të hedhin asnjë hap, kazmë apo lopatë për të gërmuar në terren.

Po kështu, në ecurinë e procesit të gjetjes së personave të zhdukur rezulton se Autoriteti, në dijeninë time, ka mungesa të theksuara të dokumentacionit, i cili normalisht duhet të jetë në arkivin e Ministrisë së Brendshme, si për shembull ekzistenca e togave të pushkatimit që kanë funksionuar pranë policisë; hartat e vendvarrimeve; raportet e kufirit mbi vrasjet në kufi; korrespondencat e kabinetit të ish-ministrit, sidomos raportimet në sekretariatet e ish-Byrosë Politike të ish-Komitetit Qendror të ish-Partisë së Punës së Shqipërisë e të tjera; vendndodhje që unë nuk jam në gjendje t'i përcaktoj, por mbetet detyrë e specialistëve përkatës, e cila normalisht mund të parashikohet e të lihet detyrë nga kjo rezolutë, jo vetëm për Autoritetin, por edhe për institucionet e tjera, të cilat disponojnë të dhëna dhe informacione për këto raste.

Parlamenti nuk mund të mjaftohet vetëm me rezoluta e raportime formale, por të ngrejë grupe për inspektim. Në rastet kur gjendet dokumentacion i këtij lloji nëpër institucione që ende sot, pas 6 vjetësh të fillimit të veprimtarisë së Autoritetit, nuk është dorëzuar në destinacion, tek Autoriteti, në trajtë origjinale apo dublikat, siç dhe ligji e parashikon, personat përgjegjës të vendosen përpara përgjegjësisë, duke e trajtuar si fshehje të krimeve dhe pengim të zbatimit të ligjit e të transparencës.

Gjithashtu, do të propozoja të shtohet, të parashikohet, një detyrë për Autoritetin që në bashkëpunim me grupet e interesit, me Institutin e ish-të Përndjekurve Politikë, me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, me Ministrinë e Financave dhe me Ministrinë e Drejtësisë, të hartojnë akte e të sjellin propozime për ndërhyrje në ligj, në mënyrë që t'u jepet zgjidhje njëherë e mirë çështjeve që kanë të bëjnë me dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë dhe me trajtimin dinjitoz, ekonomik e social të tyre. Vetëm në rastin e pensioneve ka një ngërç të krijuar për shumë persona që kanë jetuar në internim apo edhe për fëmijët e lindur atje, për të cilët ka vështirësi në gjetjen e dokumentacionit për shume arsye, si parregullsitë e mbajtjes, ku ka raste kur në vendim figuron vetëm kryefamiljari, dhe, për më keq, kur dokumentacioni është zhdukur e nuk ekziston. Ndërsa, fakti është i njohur botërisht, problematika që në të kaluarën kanë qenë zgjidhur nëpërmjet komisionit trepalësh, sot mund të gjendet edhe një zgjidhje tjetër.

Shqipëria duhet t'i hetojë këto krime, t'i ndjekë penalisht ata që janë përgjegjës dhe të sigurojë dëmshpërblime për viktimat dhe familjet e tyre, kërkesa këto të ngritura, edhe nga institucionet e Bashkimit Europian, edhe nga OKB-ja. Jam i bindur se përpjekjet e qeverisë janë minimaliste dhe ka mungesë të qartë vullneti, pasi nuk është vetëm ngritja e 2 muzeve, e Shtëpisë me Gjethe dhe e Bunk'artit, që mjaftojnë për të mësuar historinë e ish-komunizmit dhe krimet e ish-Sigurimit të Shtetit, por ne duhet t'i qetësojmë vuajtjet e afërsisht 6 000 familjeve që kërkojnë ngushëllim, për të pasur mundësinë që të vendosin një tufë lule te varri i njerëzve të tyre të dashur. Duhet ta mbyllim këtë çështje që zvarritet për 32 vjet, si dhe duhet të japim kompensim për mundin, për djersën dhe për gjakun e tyre. Personat përgjegjës janë paraardhësit tuaj, si trashëgimtarë të ish-Partisë së Punës së Shqipërisë dhe të ish-Sigurimit famëkeq të Shtetit.

Shpirtrat e tyre na bëjnë thirrje nga përjetësia për të mos harruar kalvarin e vuajtjeve që ata kaluan, por edhe për një ndjesë publike nga ana juaj si mazhorancë, të cilën asnjëherë të vetme nuk e keni bërë dhe, siç duket, as që keni ndërmend ta bëni.

Faleminderit!